

Prishtinë, 30 prill 2025

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit e Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 30.08.2023, dhe Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore – Edicioni 2024/2025 (“PG”), si dhe në bazë të Ankesës së KB Sigal Prishtina të datës 29.04.2025, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së (“KAA”), me datë 30.04.2025 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 29.04.2025;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 29.04.2025 si e PABAZUAR;
- III. VËRTETOHET Vendimi Nr. 55/2024/25 i Komisionit të Garave i datës 28.04.2025

A R S Y E T I M

Më datë 29.04.2025, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga Sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Sigal Prishtina të datës 29.04.2025 (tash e tutje “Ankesa”), e cila ka të bëjë me Vendimin Nr. 55/2024/25 të Komisionit të Garave të datës 28.04.2025, (tash e tutje “Vendimi”), lidhur me mosveprimin e gjyqtarëve (mosrishikimin në IRS të tre-pikëshit të lojtarit Tekele Cotton të KB Trepça në minutën 05:05 të Ç-3) gjatë lojës KB Trepça—KB Sigal Prishtina e zhvilluar më 26.04.2025. Gjyqtarët e ndeshjes ishin Ademir Zurapovic (CC), Radmori Vjinovic (U1) dhe Zdravko Rutesic (U2).

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur dy takime lidhur me çështjen në fjalë, të dyja takimet më 30.04.2025, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Sigal Prishtina, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga KB Sigal Prishtina. Gjatë vlerësimit të lëndës, KAA gjithashtu ka analizuar me vëmendje edhe Rregullat Zyrtare të Basketbollit FIBA 2024.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia “Arbëria”, Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina


Sipas kuptimit të KAA, KB Sigal Prishtina sfidon Vendimin e Komisionit të Garave të identifikuar si më sipër sepse sipas KB Sigal Prishtina Komisioni i Garave është dashur të urdhërojë riluajtjen e ndeshjes KB Trepça—KB Sigal Prishtina të datës 26.04.2025 sepse: 1) gjyqtarët qartazi kanë bërë një gabim kur nuk kanë rishikuar në IRS tre-pikëshin e lojtarit Tekele Cotton të KB Trepça në minutën 05:05 të Ç-3; dhe 2) ky lëshim i gjyqtarëve cilësohet si shkelje materiale e rregullave të lojës në kuptim të Nenit 44.11 të PG.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Sigal Prishtina ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit të Garave, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, përfshi këtu edhe video inqizimin e rastit në fjalë, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

KAA fillimisht pranon si të bazuar dhe të pakontestueshëm pretendimin e KP Sigal Prishtina, të konfirmuar edhe Komisioni i Garave, se gjyqtarët e ndeshjes në fjalë kanë gabuar kur i kanë pranuar si të mirëqenë tre-pikëshin e lojtarit Tekele Cotton të KB Trepça në minutën 05:05 të Ç-3. Videoinqizimi i aksionit në fjalë e tregon se topi ishte qartazi ende në duart e lojtarit Tekele Cotton të KB Trepça në momentin kur skadon 24-sekondëshi.

Poashtu, KAA pajtohet dhe e konsideron të bazuar pretendimin e KB Sigal Prishtina, dhe këtu dallojmë nga arsyetimi i Komisionit të Garave, se duke dështuar që të rishikojnë në IRS tre-pikëshin e lojtarit Tekele Cotton të KB Trepça në minutën 05:05 të Ç-3, gjyqtarët kanë vepruar në kundërshtim me Rregullat Zyrtare të Basketbollit FIBA 2024. Për dallim nga Komisioni i Garave, KAA vlerëson se rregulli F-3.2 nuk është i aplikueshëm në këtë rast, sepse ky rregull ka të bëjë me ngjarje që ndodhin në 2:00 minutat e fundit të lojës dhe kohës shtesë. Në vlerësim të KAA, në rastin konkret, rishikimi nga gjyqtarët është i lejuar sipas Nenit 44 (Gabimet e Përmirësueshme), përkatësisht, Rregullit F-3.3, sepse jep diskrecion për gjyqtarët që në rastet që janë në kuadër të atyre si në rastin konkret të kenë mundësi rishikimi gjatë tërë lojës. Pra, pa dyshim që F-3.3 iu ka dhënë gjyqtarëve në fjalë të drejtën që në rastin konkret të rishikonin nëse tre-pikëshi ka qenë i rregullt apo jo.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS


Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

KAA e ka pasur parasyshë arsyetimin e Komisionit të Garave dhe deklaratën e Gjyqtarit Kryesor Ademir Zurapovic (email e datës 27.04.2025) lidhur me F-3.2 dhe F-4.2 (Coach's Challenge), mirëpo, këto nuk kanë qenë objekt shqyrtimi në këtë rast. Objekt shqyrtimi ka qenë nëse gjyqtarët kanë pasur të drejtën që të rishikojnë tre-pikëshin në fjalë, dhe përgjigja sipas F-3.3 është PO. Fatkeqësisht për lojën në fjalë dhe lojën e basketbollit në përgjithësi, gjyqtarët në fjalë nuk e kanë shfrytëzuar këtë mundësi për të përmirësuar një gabim të tyre të dukshëm sa i përket vlefshmërisë së tre-pikëshit të lojtarit Tekele Cotton të KB Trepça në minutën 05:05 të Ç-3.

Në anën tjetër, KAA e gjenë të pabazuar pretendimin e KB Sigal Prishtina, se ky mosveprim (rishikim në IRS) i gjyqtarëve ngritet në nivelin e një shkeljeje të rëndë materiale, mjaftueshëm për të merituar një vendim për riluajtje të lojës KB Trepça—KB Sigal Prishtina e zhvilluar më 26.04.2025. Neni 44.11 i PG thotë:

44.11. Nëse gjatë ndeshjes ka ndodhur shkelje e rëndë materiale të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes dhe si rezultat i këtyre shkeljeve materiale rezultati i arritur nuk është sipas konkurrencës sportive, Komisioni i Garave do ta aprovojë ankesën dhe do të kërkojë zhvillimin e ndeshjes së re, kurse skuadrës e cila ka paraqitur ankesë mjetet e deponuara për ankesë do t'i kthehen. Këtu nuk do të merret parasysh kriteri i gjyqtarëve gjatë ndeshjes sipas ndarjes së dënimeve, shkeljeve dhe performancës së tyre. Për shkak të paraqitjes objektive të fakteve rreth procedurës së ankimit, Komisioni i Garave mund të kërkojë nga SHGJFBK, një instruktor i gjyqtarëve i FIBA apo nga një komision i caktuar vlerësimin mendimin profesional (ekspertizën e gjykimit), në afat prej 48 orësh pas përfundimit të ndeshjes).

Sipas kësaj dispozite të cituar, për të urdhëruar riluajtjen e ndeshjes në fjalë, KAA-së do t'i duheshin prova konkrete se gabimi i gjyqtarëve për të shpallur të vlefshëm tre-pikëshin e lojtarit Tekele Cotton të KB Trepça në minutën 05:05 të Ç-3, “ka[] pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes dhe si rezultat i kë[saj] shkelje[je] materiale rezultati i arritur nuk është sipas konkurrencës sportive”.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

Në rastin konkret, KAA nuk ka pasur në dispozicion prova të tilla, që do t'i lejonin KAA-së që të konkludojë se ky tre-pikësh i kontestuar ka ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar. Jemi koshient për argumentimin e KB Sigal Prishtina se ai gabim ka humbur momentumin e ekipës. Pa dyshim që gabimi në fjalë i gjyqtarëve mund të ketë ndikuar negativisht lojën e KB Sigal Prishtina. Mirëpo, në vlerësim të KAA, kjo nuk mjafton që të meritojë një konkludim të KAA se ky gabim i gjyqtarëve ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes—në vecanti sepse loja kishte edhe pjesën e mbetur të Ç-3 dhe tërë Ç-4. Rrjedhimisht, edhe e konsiderojme të pabazuar pretendimin e KB Sigal Prishtina se ky gabim i gjyqtarëve ka qenë shkelje e rëndë materiale, dhe rrjedhimisht, nuk kemi bazë që të urdhërojmë riluajtjen e lojës në fjalë.

Rrjedhimisht, KAA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 30 prill 2025

Vendimi i dërgohet:

- KB Sigal Prishtina
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit të Arbitrazhit kanë të drejtë të ankesës të Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina